

RIVIERA ITALIANE (Cinque Terre - Portofino) Nisje: • 25 Shtator • 16 Tetor

DESTINACIONI

Cinque Terre -
Portofino

PERIUDHA

Shtator-Tetor '2026

KOHËZGJATJA

3 Ditë

TRANSPORTI

Me Avion



SHTATOR 2026



Nisje 25 Shtator - Kthim 27 Shtator

- 3 Ditë / 2 Netë

- Çmimi: **399€**



- Nisja: 10:30 (Tiranë) → 12:15 (Piza)



- Kthimi: 21:50 (Milano) → 23:45 (Tiranë)



TETOR 2026



Nisje 16 Tetor - Kthim 18 Tetor

- 3 Ditë / 2 Netë

- Çmimi: **399€**



- Nisja: 10:30 (Tiranë) → 12:15 (Piza)



- Kthimi: 21:50 (Milano) → 23:45 (Tiranë)

1

DITË

Dita 1: Lucca - Forte dei Marmi - Viareggio

- Takimi me guiden ne aeroportin e Tiranes dhe nisja per Piza me fluturin direkt (1:35 min)
- Pas mberitjes ne Piza, nisja me **autobus** drejt Lucca-s. Hyni në magjinë e Italisë duke eksploruar **Lucca-n historike**, qytet historik i rrethuar nga mure mesjetare, ku rrugicat e ngushta dhe sheshet karakteristike krijojnë atmosferë autentike italiane. Shëtitje në qendër për të vizituar **Piazza dell'Anfiteatro** dhe kishën e famshme **San Michele**, duke përjetuar bukurinë e historisë dhe arkitekturës.
- Vazhdimi i turit në **Forte dei Marmi**, qytet elegant bregdetar, me promenadë piktoreske dhe pamje panoramike të detit dhe kodrave.
- Dita përfundon me mbrëmje në **Viareggio**, qytet i njohur për shëtitoren historike, arkitekturën art-deco dhe atmosferën urbane të gjallë, perfekte për një shëtitje të qetë pas udhëtimit.
Akomodimi në hotel në Viareggio

2

DITË

Dita 2: Cinque Terre (La Spezia + Monterosso, Vernazza, Manarola)

- Mëngjesi në hotel
- Nisja me **autobus** drejt La Spezia, porti hyrës për të eksploruar fshatrat piktoreskë të Cinque Terre.
- Përjetoni **magjinë e Cinque Terre**, destinacion i mbrojtur nga UNESCO, ku secili fshat ka ngjyrat dhe karakterin e tij unik. Transferim në stacionin e trenit dhe përdorimi i **trenit lokal Cinque Terre Express** për të vizituar fshatrat **Monterosso, Vernazza, Manarola dhe Riomaggiore**.
- Shëtitje dhe fotografi në rrugicat karakteristike të secilit fshat, duke shijuar atmosferën autentike dhe peizazhet mahnitëse të bregdetit Ligurian.
- Opsionale: një shëtitje e shkurtër përgjatë **Sentiero Azzurro**, rruga bregdetare që lidh fshatrat dhe ofron pamje panoramike të jashtëzakonshme.
Kjo është një ditë plot **ngjyra, histori dhe peizazhe që do të mbeten në kujtesën tuaj**, ideale për fotografi të paharrueshme dhe për të përjetuar shpirtin e vërtetë të Italisë.
- Rikthim me **autobus** drejt **Viareggio**, për mbrëmje të qetë dhe akomodim në hotel.
Akomodimi në hotel në Viareggio

- Mëngjesi në hotel
- Nisje me **autobus** drejt **Santa Margherita Ligure**, qytet bregdetar me port piktoresk dhe atmosferë elegante mes vilave dhe kafeneve.
- Nga Santa Margherita Ligure, ju rekomandojmë **ekskursionin me varkë në Portofino**, për të përjetuar panoramën e jashtëzakonshme të gjirit, vilat bregdetare dhe portin e famshëm nga deti. Shëtitje dhe fotografi në qendrën e fshatit, për të përjetuar atmosferën ekskluzive dhe magjike të destinacionit.
- Kthim me **varkë** në Santa Margherita Ligure dhe pak kohë e lirë për të shijuar portin dhe dyqanet lokale.
- Nisja **autobus** drejt **Milanos**, për të përfunduar udhëtimin në Aeroportin e Malpensa me kujtime të paharrueshme nga Riviera Italiane.

ÇFARË PËRFSHIHET

✓ PËRFSHIHET

- ✓ Udhëtimi vajtje-ardhje me avion Tiranë - Piza dhe Milano - Tiranë. Transfertat dhe Shëtitjet me autobus sipas programit. Akomodimi në hotel 3 Yje ose 4 Yje për 2 netë në Viareggio Mëngjeset për të gjitha ditët e udhëtimit. Shoqërues shqiptar gjatë qëndrimit jashtë Shqipërisë. Lejohet të merret me vete në avion vetëm një çantë me përmasa deri në 40 x 30 x 20cm. (Kujdes - Mbi këto përmasa dhe Bagazh për checkin ka shpenzime ekstra).

× NUK PËRFSHIHET

- × Drekat dhe Darkat Biletat e hyrjes në Muze dhe Monumente Turistike Taksat e qyteteve (paguhen në reception pas check out nga hoteli) Bileta e Trenit në Cinque Terre për të gjitha stacionet (35-40€) Ekskursionin me anije në Portofino (18-20€)

VENDTAKIMI I NISJES

► Nga aeroporti Nënë Tereza, ku duhet të paraqiteni minimumi 2 orë përpara

STACIONET E TRENIT NE CINQUE TERRE

Segmenti	Kohezgjatja
La Spezia → Riomaggiore	rreth 9-10 min
Riomaggiore → Manarola	rreth 3-6 min
Manarola → Vernazza	rreth 2-4 min
Vernazza → Monterosso	rreth 4-5 min
Monterosso → La Spezia	rreth 25 min

Ne total bilet e trenit per te gjitha levizjet kushton 35-40 euro. Biletat blihen ne stacionin qendror te trenit ne La Spezia

POLITIKAT E ÇMIMIT PËR FËMIJËT

► Fëmijët në moshën 2 - 11.99 vjeç përfitojnë 20€ zbritje nga cmimi i paketës

Shenim: Kjo politike hyn ne fuqi vetëm nëse femijët akomodohen në dhomë me 2 të rritur.

DOGANA

1) Pashaportë me vlefshmëri minimumi 3 muaj

2) Nuk duhet të keni kaluar në 6 muaj e fundit më shumë se 90 ditë qëndrimi në vendet e BE

INFORMACIONE

- Akomodimi në dhomë teke (single) është me ekstra pagesë në vlerën 30% mbi çmimin për person.
- Nëse krevati nuk do të jetë dopio, atëherë do të jenë dy krevatë teke të bashkuar.
- Nëse shtrati për personin e tretë/katërt nuk do të jetë standart, atëherë do të jetë sofa bed (shtrat i shtuar në dhomë).
- Operatori Turistik nuk mban përgjegjësi për personat e kthyer nga policia për arsye të ndryshme sic janë mungesë dokumentacioni, ekspuls, skadencia e mjetit identifikues, etj.
- Nëse nuk i keni mbushur 18 vjeç dhe udhëton pa praninë e njërit ose asnjërit prej prindërve, ju nevojitet prokurë e noterizuar në gjuhën angleze.
- Ekziston mundësia që disa nga përmbajtjet e hotelit/udhëtimit të mos jenë aktualisht në funksion për shkak të rrethanave objektive, të cilat operatori nuk mund të ndikojë.
- Cmimet dhe disponueshmëria e muzeumeve, ekskursioneve dhe cdo aktivitet tjetër lokal mund të ndryshojnë dhe janë përgjegjësi e vetë Operatorëve Lokale që mundësojnë këto shitje.

Për cdo ndryshim në lidhje me këto aktivitete, klienti lajmërohet përpara kryerjes së shërbimit.

DESTINACIONI	Cinque Terre - Portofino
TRANSPORTI	Me Avion
ÇMIMI	€399.00 / person
ZBRITJE FËMIJË	99% (€5.00)
GJENERUAR	19/05/2026 12:48